



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT I MINISTRISË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
2022

<https://punetejashtme.gov.al/>

TABELA E PËRMBAJTJES

1.Përmbledhje Ekzekutive

2.Qasja metodologjike e raportit

3.Gjetjet e raportit

3.1. Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator të ministrisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, si dhe informimin e punonjësve për etikën

3.2. Objektivi 2: Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jo civil, që karakterizohet nga etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmërinë në të gjitha nivelet

3.3. Objektivi 3: Rritja e transparencës së punës së realizuar, politikave të hartuara dhe miratuara, angazhimeve të ndërmarra në politikën e jashtme dhe procesit të integritetit evropian ndaj publikut

4.Konkluzione dhe rekomandime

LISTA E SHKURTESAVE

MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
PI	Plan Integriteti
KI	Konflikt interesi
DAB	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
DBNJ	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DDE	Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike
DAAA	Drejtoria e Amerikave, Azisë dhe Afrikës
GPI	Grupi i punës për integritetin
PT	Programi i transparencës
KNJKP	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

1.Përmbledhje Ekzekutive

Korrupsioni, konflikti i interesit, mungesa e etikës janë fenomene që favorizojnë përjashtimin, pabarazinë dhe mosbesimin në institucionet publike. Asnjë institucion shtetëror nuk është imun ndaj këtyre fenomeneve, përfshirë edhe MEPJ-në, prandaj lufta kundër këtyre fenomeneve dhe parandalimi i tyre është përgjegjësia primare institucionale e MEPJ, e cila rëndon mbi çdo nëpunës të saj, në gjithë ushtrimin e politikës së jashtme dhe koordinimin e integritit evropian.

Në kuadër të optimizimit të veprimtarisë dhe përmbushjes së detyrimeve të sipërpërmendura, në luftën kundër korrupsionit, MEPJ në vitin 2022 hartoi PI, si një instrument që materializon angazhimin dhe përpjekjet e saj, për të forcuar institucionin në parandalimin e korrupsionit, në përfitimin e një kulture të menaxhimit publik me etikë dhe integritet, duke i konsideruar si gurë themeli të një qeverisje të mirë. PI i MEPJ-së është miratuar me Urdhër të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtëm, nr.150, datë 28.04.2022.

Qëllimi i miratimit është diktuar nga nevoja për forcimin e integritetit të nëpunësve të ministrisë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të cenimit të integritetit institucional, duke synuar realizimin e fushës së përgjegjësive të MEPJ-së sa më mirë të jetë e mundur. Miratimi i PI nga institucionet qendrore, konkretisht MEPJ, është një hap më shumë në përmbushjen e angazhimit të qeverisë në luftën kundër korrupsionit, mbi të gjitha, me qëllim deklarimin e vullnetit për të mundësuar një mjedis pune me integritet, mbarëvajtjen e punës në institucion dhe rritjen e besimit të publikut ndaj veprimtarisë së MEPJ-së.

Monitorimi i zbatimit të planit, ka kërkuar vullnetin e mirë, ndjekjen me korrektësi dhe angazhimin serioz të Koordinatorit të Integritetit. Plani i Integritetit i MEPJ-së ka të parashikuara arritjen e 5 (pesë) objektivave, që synohet të realizohen nëpërmjet 94 masave, përkundrejt riskut të evidentuar, sipas afatit të zbatimit të planit 2022 deri në vitin 2025.

Ky raport është i pari dokument dëftues për ecurinë e zbatimit të PI, që pas miratimit të tij në Prill 2022. Raporti përmban të dhëna për masat e caktuara për zbatim për periudhën Prill-Dhjetor 2022, sipas objektivave përkatëse, për afatin e zbatimit dhe njësitë përgjegjëse të angazhuara për zbatim.

Për vitin 2022 (prill-dhjetor), PI i MEPJ-së ka të përcaktuara 13 masa, të parashikuara në 3 prej 5 objektivave në total, të cilat konsistojnë si më poshtë vijon:


- Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator të ministrisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, si dhe informimin e punonjësve për etikën;
- Objektivi 2: Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jociwil, që karakterizohet nga etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmërinë në të gjitha nivelet;
- Objektivi 3¹: Rritja e transparencës së punës së realizuar, politikave të hartuara dhe miratuara, angazhimeve të ndërmarra në politikën e jashtme dhe procesit të integritit evropian ndaj publikut.

¹ I listuar i 3-ti për efekt renditje, por është objektivi i 5 i PI

Nga procesi i monitorimit lidhur me zbatimin e masave nga njësitë përgjegjëse rezultoi se: në totalin prej 13 masash, janë zbatuar plotësisht 11 prej tyre dhe 2 janë ende në proces realizimi, sakaq nuk rezulton asnjë masë e pa realizuar.

Raporti për zbatimin e masave, pasqyron të dhëna konkrete për llojin e aktivitetit, që përfshinë objektivin e synuar për tu arritur, masën ose aktivitetin, prioritetin, strukturën përgjegjëse dhe afatin e realizimit. Gjithashtu, përmban të dhëna të grumbulluara gjatë monitorimit të zbatimit të masës, që lidhen me hapat e ndërmarrë, dokumentet që janë hartuar/publikuar me qëllim realizimin e masës, njësinë përgjegjëse për zbatimin, nivelin në të cilin është realizuar, ndikimin që pasur realizimi i masës, problematikat që ka hasur njësitë përgjegjëse gjatë zbatimit dhe rekomandimet e saj, si dhe lloji i buxhetit të parashikuar.

Statu i Zbatimit të Planit të Integritetit



Objektivat e PI të MEPJ për vitin 2022	Masa dhe aktivite	Realizimi i masave dhe aktiviteve për vitin 2022			
		Realizimi i aktiviteve të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivite të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivite të realizuara pjeserisht	Masa dhe aktivite të parealizuara
3 nga 5 në total	13 nga 93	13	11	2	-

2. Qasja metodologjike e raportit

Për finalizimin e procesit të monitorimit për periudhën Prill-Dhjetor 2022, që materializohet nëpërmjet këtij raporti, është kryer një punë që ka konsistuar në bashkëpunimin e disa drejtorive të MEPJ-së, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, si dhe të Koordinatorit të Integritetit. Këta aktorë kanë ndërvepruar për raportimin dhe mbledhjen e informacionit mbi zbatimin e masave, është analizuar zbatimi i secilës masë, hapat e ndërmarrë, problematikat dhe rekomandimet e mundshme. Raporti përmban një analizë cilësore dhe sasiore të veprimtarisë kontribuese të drejtorive si njësi përgjegjëse.

Të dhënat e raportuara nga drejtoritë në cilësinë e njësive përgjegjëse, janë grumbulluar dhe përpunuar nga Koordinatori i Integritetit të MEPJ-së, si personi përgjegjës për mbledhjen, analizën e informacionit dhe hartimit të raportit të monitorimit.

Koordinatori i Integritetit ka koordinuar punën me sektorin e ankesave administrative dhe përfaqësimit gjyqësor për mbledhjen e informacionit, duke ju drejtuar njësive përgjegjëse në formë të shkruar apo duke zhvilluar takime në formë “interviste” për të pasur informacion të detajuar mbi nivelin e zbatimit të masave dhe verifikueshmërinë e tyre. Është vijuar me sistemimin e të dhënave për pasqyrimin sa më konciz në këtë raport, përdorimin e një gjuhe sa formale edhe të thjeshtë, që të jetë i kuptueshëm edhe për publikun, për shkak se ky raport do të publikohet në programin e transparencës, në faqen zyrtare të MEPJ.

Njësitë përgjegjëse, të cilat kanë raportuar për zbatimin e masave për këtë periudhë 9 (nëntë) mujore janë si më poshtë:

- Drejtorja e Burimeve Njerëzore;
- Drejtorja e Diplomacisë Ekonomike;
- Drejtorja e Auditit të Brendshëm;
- Koordinatori për të Drejtën e Informimit;
- Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Secila njësi ka raportuar brenda afatit të caktuar nga Koordinatori i Integritetit. Kontributi i tyre shtrihet në drejtim të nivelit të zbatimit të masës përkatëse, aktet e publikuara, të dhënat për buxhetin, problematikat dhe rekomandimet e mundshme.

Raporti është hartuar duke u bazuar në analizën e të dhënave që drejtoritë/personat përgjegjës kanë raportuar, si në rrafshin cilësor edhe sasior. Konkretisht, analiza cilësore konsiston në vlerësimin e zbatimit të masave sipas drejtimit të tyre dhe fushës/objektivave të synuara, ndërsa analiza sasiore është kryer bazuar në të dhënat statistikore.

Raporti, në përfundim, pas miratimit të draft-raportit nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, miratohet nga Ministri i MEPJ-së dhe bëhet publik në faqen zyrtare.

3.Gjetjet e raportit

3.1. Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator të ministrisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, si dhe informimin e punonjësve për etikën

Ky objektiv nënvizon rëndësinë dhe sfidat e etikës publike dhe llogaridhënies në ministri. Përmes tij demonstron rolin e rëndësishëm që luan etika dhe llogaridhënia publike në përmbushjen e qeverisjes së brendshme që karakterizohet nga efikasiteti, transparenca dhe pjesëmarrja.

Për këtë periudhë raportimi, ky objektiv përmban vetëm 2 masa specifike të planifikuara për realizim deri në përfundim të vitit 2022, që konsistojnë si më poshtë:

1. *Hartimi i një plani strategjik për MEPJ, është parashikuar të realizohet nëpërmjet një grupi pune me punonjës të MEPJ-së.* Aktualisht kjo masë është në proces realizimi (finalizimi), pas ngritjes së grupit të punës për këtë qëllim, konkretisht, Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe nëpunësit e saj.

2- *Mbajtja e takimeve periodike mes drejtorit dhe kabinetit. Mbajtja e procesverbaleve mbi diskutimet dhe ndjekja e tyre periodikisht nga kabineti dhe drejtoritë.* Kjo masë shfaqet me prioritet të mesëm, dhe për tu zbatuar në 6-të mujorin e dytë të vitit 2022 dhe në vazhdim. Struktura përgjegjëse për realizimin e saj është Kabineti i Ministrit dhe drejtoritë. Evidentohet dhe nga procesverbalet e mbledhjeve se kjo masë për këtë periudhë raportimi është realizuar plotësisht.

Objektivi 1	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të përealizuara
Përmirësimi i kuadrit rregullator	Masa/aktivitete	2	1	1	-

3.2. Objektivi 2: Përmirësimi i burimeve njerëzore duke konsoliduar një administratë në shërbimin e jashtëm, shërbimin civil dhe administratën e shërbimit jo civil, që karakterizohet nga etika dhe integriteti, duke forcuar përgjegjshmërinë në të gjitha nivelet.

Përmes këtij objektivi synohet të arrihet përforcimi i dhe përmirësimi i burimeve njerëzore të MEPJ-së, në të gjithë kategoritë e burimeve njerëzore duke përfshirë, nëpunësit e shërbimit të

jashtëm, nëpunësit e shërbimit civil si dhe të shërbimit teknik. Etika dhe integriteti përgjithësisht konsistojnë në zbatimin e vlerave thelbësore dhe standardeve të larta të sjelljes nga zyrtarët publik.

Krijimi i një kulture integriteti mund të jetë i vështirë për shkak të lidhjes së dyanshme mes autoritetit shtetëror dhe pushtetit në vendimmarrje, që jepen në ushtrimin e funksioneve publike, gjë që do të thotë që mundësitë dhe stimujt për përfitime të paligjshme mund të jenë të shumta.

Kështu, edhe konsolidimi dhe forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri, si për kategorinë e nëpunësve të shërbimit të jashtëm, si për të shërbimit civil, apo edhe të kategorisë së shërbimit teknik dhe të mirëmbajtjes, është shumë i rëndësishëm për të pasur një administratë publike efikase, transparente, të përgjegjshme dhe të pa korrumpuar në të gjitha nivelet.

Për këtë periudhë monitorimi, prill-dhjetor 2022, për përmbushjen e objektivit të sipërcituar, janë përcaktuar për zbatim 5 masa/aktivitete nga njësitë e përcaktuara.

Njësitë përgjegjëse/raportuese për këtë përmbushjen e këtij objektivit janë: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike, të cilat kanë realizuar masat në nivelet e treguara si në tabelën e mëposhtme:

Objekivi 2	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Përmirësimi i burimeve njerëzore	Masa dhe aktivitete	5	5	-	-

Nga grumbullimi dhe analiza e të dhënave rezulton se, DBNJ si njësi përgjegjëse ka realizuar masat që konsistojnë në dorëzimin e përshkrimeve individuale të punës për çdo punonjës. Afati i zbatimit të kësaj mase nuk është i prerë në mbyllje të vitit 2022, por do të vijojë edhe përgjatë vitit 2023 me takime periodike informuese të punonjësve të ministrisë, që këta të fundit të kuptojnë sa më qartë detyrat e tyre.

DBNJ rregullisht në përfundim të çdo gjashtëmujori ka bërë stafit drejtues dhe përfaqësive diplomatike të MEPJ-së, njoftime dhe rikujtesa për detyrimin ligjor për realizimin e procedurës së vlerësimeve në punë. Në rast vonesash, tejkalimit të afatit, është tërhequr vëmendje për plotësimin e këtij detyrimi në afat. Zbatimi i kësaj mase verifikohet nga shkresat dhe komunikimet elektronike që DBNJ i ka adresuar drejtorive.

Përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2022, me Urdhër nr. 124, datë 04.08.2022, të Kryeministrit, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 138, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme” të ndryshuar janë përcaktuar ndryshime në organikën e MEPJ-së. Kështu kanë ndryshuar dhe nevojat në DBE. Andaj, sa i takon plotësimin të vakancave në DBE, nëpërmjet ndjekjes së procedurës nga DBNJ, drejtori e ngarkuar me raportimin e vendeve vakante në DAP me qëllim plotësimin e tyre, konkretisht në Drejtorinë e BE-së, me urdhrin e sipërcituar, struktura e Drejtorisë së Bashkimit Evropian është 1 drejtor dhe 4 specialistë dhe rezulton e plotësuar, pa vakanca.

DSHB në kuadër të realizimit të masës “Identifikim i nevojave për trajnime dhe ofrimi i trajnimeve brenda dhe jashtë vendit në përputhje me politikat e institucionit”, së bashku me Akademinë Diplomatike, ka njoftuar stafin e MEPJ-së për çdo trajnim të ofruar, si brenda edhe jashtë vendit. Përgjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2022, janë organizuar një sërë trajnimesh dhe seminaresh si më poshtë vijon:

1. *Akademia për zgjerim, Poloni;*
2. *Trajnim për diplomat të rinj, GIZ, Kroaci;*
3. *Skills for the neë European Diplomat, Itali;*
4. *Trajnim për diplomat të rinj, GIZ, Belgjik;*
5. *Seminar Rajonal- VIS i BE-së, Mal i Zi;*
6. *Kontrolli i eksporteve të armëve dhe transferimi i teknologjive, Gjeorgji;*
7. *Health diplomacy, Bullgari;*
8. *Shkolla verore “Gavro Vukoviç”, Mal i Zi;*
9. *Iniciativa e Ballkanit të Hapur, Serbi;*
10. *Seminar KE, “Detyrueshmëria dhe zbatimi i sanksioneve”, Maqedonia e Veriut.*

Në këto trajnime kanë marrë pjesë në total 18 nëpunës dhe diplomatë nga MEPJ. Vlen të përmendet se mundësia për trajnim dhe kualifikim e stafit të MEPJ, do të jetë në vazhdimësi.

Nga Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike, një tjetër strukturë përgjegjëse për përmbushjen e objektivit të sipërcituar, janë realizuar plotësisht përgjatë këtij gjashtëmuajori, takime periodike (korrespondenca shkresore dhe online, komunikime verbale, fizike dhe elektronike, informale dhe formale, me zyrtare dhe përfaqësues biznesi e shoqëri civile me institucionet e tjera) që adresojnë çështje të ndërveprimit ekonomik me palë të treta.

Përkushtimi dhe angazhimi i DDE ka çuar në realizim të plotë të masës së përcaktuar për zbatim lidhur me fuqizimin e dimensionit të diplomacisë ekonomike në kuadrin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe interesave strategjik të vendit, rritjen e vizibilitetit ndërkombëtar, sensibilizimin dhe nxitjen e interesit për pjesëmarrje ndërkombëtare dhe investime në sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare, promovimin e vendit.

Janë hasur problematika si: feedbacku nga institucionet që u drejtohen, lidhur me reagimet, si në kohë dhe në përmbajtje. Shpesh përgjigjet edhe pse me vonesë, rezultojnë jo shteruese, dhe nuk japin përgjigje efektive. Gjithashtu, janë vënë re problematika të shfaqura në formën e neglizhencës dhe anashkalimit të MEPJ nga Ministrinë e linjës, si ne rastin e vizitave in/out, dhe në rastin e pritje/përcjelljeve apo takimeve me përfaqësues të trupit diplomatik, apo komunikime me homologë të tyre nga vendet e tjera, janë praktika që duhet të ndryshojnë. Në këtë rast

problemi nuk është takimi, por raportimi dhe kërkesa për suport apo orientim në qëndrim, apo dhe në tematika për diskutim kur kemi çështje të natyrës sensitivë, prandaj DDE rekomandon që çdo ministri duhet ta ketë taksative njoftimin dhe konsultimin paraprak me MEPJ. Mangësitë dhe problematikat e pasqyruara më sipër, që konsistojnë në mungesën e raportimit, koordinimit, konsultimit dhe informimit, sjellin pasoja tek dosja finale e cila sigurisht që do të çëdojë dhe reflektojë mungesa në të gjithë elementët e saj.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

3.3. Objektivi 3: Rritja e transparencës së punës së realizuar, politikave të hartuara dhe miratuara, angazhimeve të ndërmarra në politikën e jashtme dhe procesit të integritetit evropian ndaj publikut

Ky objektivi synon publikimin e informacioneve të plota për rezultatet dhe implikimet e politikave të ministrisë dhe procesin e vendimmarrjes. Publikimi i informacionit për politikën, programet dhe aktivitetet e ministrisë u mundëson aktorëve të interesuar dhe publikut të kuptojnë më mirë punën e qeverisë, për të bërë zgjedhje të bazuara në informacione dhe të angazhohen më aktivisht në proceset e vendimmarrjes. Veç sa më sipër, aksesit në informacion është me rëndësi të madhe edhe për mediat dhe përfaqësuesit e shpërndarës civile, që këta të fundit të përmbushin me sa më shumë efikasitet funksionet e tyre.

Për periudhën prill-dhjetor 2022 ky objektivi përfshin në total 6 masa/aktivitete për tu realizuar nga njësitë e përcaktuara shprehimisht në PI. Fokusi i masave dhe pritshmëritë në rezultate lidhen me transparencën, e parë në kuadër të publikimit të dokumenteve që janë hartuar në këtë periudhë, publikimit të angazhimeve ose projekteve të ndërmarra nga MEPJ në politikën e jashtme dhe procesit të integritetit evropian.

Strukturat e ngarkuara me detyrimin e zbatimit dhe raportimit të masave të përcaktuara janë përkatësisht:

1. Sekretari i Përgjithshëm;
2. Drejtoria e Auditit të Brendshëm;
3. Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
4. Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Nga monitorimi, niveli i zbatimit të masave nga strukturat përgjegjëse, rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Objektivi 3	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022	Masa dhe aktivitete të realizuara plotësisht	Masa dhe aktivitete të realizuara pjesërisht	Masa dhe aktivitete të parrealizuara
Transparenca e MEPJ	Masa/aktivitete	6	5	1	-

Në funksion të përmbushjes së këtij objektiivi, janë realizuar aktivitetet e përcaktuara me fokus rritjen e transparencës. Ndër aktivitetet e parashikuara nga totali prej 6 aktiviteteve, janë realizuar plotësisht 5 prej tyre, dhe 1 është ende në proces.

Pozicioni i Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik ka pësuar ndryshime dhe nuk ka rezultuar i qëndrueshëm, për shkak të transferimit të Koordinatorit të mëparshëm në një pozicion tjetër punë. Kjo ka sjellë vonesa në përditësimin e kredencialeve të Koordinatorit aktual nga AKSHI, si pasojë Koordinatorit nuk ka ende akses në sistem për të publikuar raportin e

gjashtëmuorit të parë, i cili nuk u publikua brenda afatit për shkak të ngërçit që shkaktoi sulmi kibernetik. Raporti vjetor 2022 do të publikohet në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në datën 31.1.2023. Ndryshimet e ndodhura, janë përditësuar në faqen zyrtare të MEPJ-së, në rubrikën dedikuar programit të transparencës, në lidhjen: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/113>

MEPJ, nëpërmjet Koordinatorit për të drejtën e informimit ka treguar transparencë, duke informuar çdo qytetar në postën elektronik të dedikuar, si dhe duke respektuar kërkesat ligjore në fuqi për publikim e regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeje, e cila mund të aksesohet në lidhjen : <https://punetejashtme.gov.al/publikime/> . Koordinatori për të drejtën e informimit ka realizuar si dhe do të vazhdojë të realizojë komunikime me drejtoritë për t'i rikujtuar mbi përditësimin e PT.

Sekretari i Përgjithshëm në respektim rigoroz të legjislacionit në fuqi, por dhe në zbatim të PI, ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm përgjatë kësaj periudhe, për miratimin e disa akteve me rëndësi si: caktimi i KNJKP, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar kanë hartuar aktin për vendosjen e tarifave për të drejtën e informimit. Akti është hartuar dhe është në proces miratimi nga Ministri i MEPJ-së.

Në vazhden e publikimeve në funksion të forcimit të transparencës, është bërë publikimi i Kartës së Auditimit dhe Gjurmës së Auditimit, i pasqyruar në lidhjen <https://punetejashtme.gov.al/ep-content/uploads/2022/12/Karta-e-auditimit-t%C3%AB-brendsh%C3%ABm.pdf> të PT, seksioni “Auditi i Brendshëm”, iniciuar nga DAB.

MEPJ, veç lidhjeve të bashkëngjitura më sipër konform zbatimit të masave korresponduese, ka përditësuar plotësisht rubrikën e veçantë dedikuar Programit të Transparencës, në lidhjen : <https://punetejashtme.gov.al/programi-i-transparences/>.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

4.Konkluzione dhe rekomandime

Ky raport është akti/dokumenti i parë i publikuar që dëshmon monitorimin dhe respektimin e zbatimit të Planit të Integritetit nga strukturat përgjegjëse në MEPJ. Periudha e raportimit nis pikërisht me momentin kur PI është miratuar, prill 2022, periudhë e cila u pasua nga shfaqja e

disa vështirësive ose pengesave që kanë ndikuar dhe në ecurinë e zbatimit të PI. Sulmi kibernetik në periudhën korrik-gusht, afektoi jo vetëm ecurinë e përditshme të punës në ministri, por pati ndikim dhe në ecurinë dhe zbatimin e disa prej masave të përcaktuara. Pavarësisht sfidave, MEPJ me të gjitha strukturat e angazhuara ka vepruar e udhëhequr nga përgjegjësia dhe vullneti i mirë për zbatimin dhe përmirësimin e mundshëm. Përgjatë vitit 2022 është hartuar dhe miratuar PI, duke konsideruar angazhimin e grupit të punës, orët shtesë dhe ngarkesën e punës në detyrat e tyre të përditshme, sipas pozicioneve në ministri.

Në përfundim të gjithë sa më sipër kemi konstatuar, trajtuar dhe analizuar, rezulton se për vitin 2022:

- MEPJ është angazhuar dhe ka miratuar PI;
- Në kuadër të zbatimit të PI, strukturat përgjegjëse kanë vepruar me qëllim realizimin e masave përkatëse me përgjegjshmëri;
- Rritur performanca e burimeve njerëzore në të gjitha nivelet, janë kryer trajnime, janë informuar punonjësit për detyrat e tyre, janë realizuar vlerësimet e performancës në punë;
- Miratimi i organikës së re me Urdhrin e Kryeministrit nr.124, datë 4.8.2022, “Për disa ndryshime në organikën e MEPJ”, ka ndikuar pozitivisht duke përmbushur nevojat e ministrisë sipas fushës së përgjegjësisë së saj.
- Është realizuar detyrimi për të pasur një administratë transparente në veprimtari dhe vendimmarrje, nëpërmjet ngirtjes së kapaciteteve për rolin e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, si dhe të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.

Në vazhdimësi rekomandojmë:

- Të vijohet me mbajtjen e kontakteve midis Koordinatorit të Integritetit dhe njësive përgjegjëse për zbatim për vitin 2023;
- Të përfundohen pa shumë vonesa miratimet e akteve që janë ende në proces;
- Hartimi i një politike privatësie për institucionin;
- Trajnime mbi konfliktin e interesit;
- Hartimi dhe miratimi i modeleve tip të përcjelljes së dokumentacionit;
- Ofrimi i sesioneve informuese për punonjësit e ministrisë mbi informacionin e klasifikuar;
- Hartimi dhe miratimi i një procesverbali për dorëzimin e detyrës për punonjësit;
- Hartimi dhe miratimi i një plani vjetor për trajnimet;
- Hartimi dhe miratimi i formateve tip për rastet e veprimtarive të dyta që kryhen nga punonjësit.
- Të respektohet afati i caktuar për zbatimin e çdo mase të parashikuar për vitin 2023.